



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality Assambly
Hani i Elezit



01/Nr. 7672/2023
Data : 11.09.2023

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tetë -VIII- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 22.08.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkyrytar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtëor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtëor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare në Drejtorin e Arsimit).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2023.
3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.
4. Kërkesë për shqyrtimin e aktit për vendimin me numër 01/5269/2023.
5. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023.
6. Informatë për korrije shirjet.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershori 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- gjatë kësaj periudhe janë mbajtur takime, kemi arritur marrëveshje, kemi hartuar projekte dhe i kemi rritur subvencionimet. Në material i keni të shënuara në detaje dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- kërkoj sqarim te projektet e hartuara, irregullimi i hapësirave publike , zgjerimi i rrugëve dhe irregullimi i parkut afër lumit Lepenc. Rruga që do të zgjerohet a do të rrënohen lokalet të gjitha .

Sevdi Dernjani thekson:-për zgjerim të rrugës kemi marrëveshje të mirëkuptimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe për këtë vit janë të planifikuara 60 000 € . Lokalet do të hiqë por do të njoftohen me kohë.

Sherif Berisha thekson:- te çështja e takimeve po më doket boshe se çfarë takime ka pasur dhe a ka diçka konkrete për takimet që i ka pasur me rëndësi . Në materialin që na është dërguar nuk shënon asgjë për çështjen e ujit dhe problemi i ujit po vazhdon sikur në qeverisjen e kryetarit të më hershëm dhe i njëjtë avaz dhe nuk kemi ujë.

Sevdi Dernjani thekson:- në formën të cilën e kemi paraqitur si tituj i ke të gjitha takimet që i kemi cekur dhe nëse jeni të interesuar për takimet që janë realizuar i keni të gjitha postimet në rrjetet sociale dhe në vebfaqe të komunës.

Ibadete Kalisi thekson:- te zgjerimi i rrugës te zona kufitare a keni menduar për kamionët për me pasur ndonjë pjesë të veçantë.

Sevdi Dernjani thekson:- një ndër arsyet kryesore që do t bëhet demolomi i atyre objekteve dhe zgjerimi i rrugës ka qenë arsy që me u liruar hapësira e komunikacionit pra do të bëhet një korsi për kamionët.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- përvëç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- taksa për te çerdhja ishte propozuar që ngritet.

Vjosa Rogaçi thekson:-çmimet në të gjitha çerdhet në Kosovë janë ngritur në mënyrë që me pasur cilësi.

Refet Kalisi thekson:- tarifa për gurëthyesit është e njëjtë , mirëpo kompania “Preni” nuk punon dhe a ka ndonjë lehtësim. Bizneset a kanë të kryera obligimet ndaj komunës dhe është mirë me najë përcjell një raport.

Majlinda Kaloshi thekson:-çdo biznes që e ushtron veprimtarin në Han të Elezit duhet të ngarkohet me taksë dhe kompania mund të parashtron kërkesë në komunë dhe t'i paraqet dëshmitë e qarkullimit se a është duke vepruar apo jo dhe pastaj komisioni e vlerëson. Bizneset kanë obligime ndaj komunës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Kërkesë për shqyrtimin e aktit për vendimin me numër 01/5269/2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- në material e keni shkresën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila ka kërkuar që të bëhen disa ndryshime .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PËR SHQYRTIMIN E AKTIT PËR VENDIMIN ME NUMËR 01/5269/2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- a do të fillon mësimi me datë një shtatorë sepse siç i kam parë punimet që janë duke u zhvilluar ndoshta është problem me filluar me kohë dhe nuk e di pse këto planifikime ditët e fundit para fillimit të vitit shkollorë për shkak se ka pasur kohë me u kryer me kohë dhe nuk i di arsyet pse me ndodhur kështu.

Sevdi Dernjani thekson:- në kushte normale duhet të fillon me datë një shtatorë mësimi, ndërsa për çështjet tjera në mbledhje të kuvendit drejtori jep sqarime.

Sherif Berisha thekson:- drejtori duhet të merr pjesë në mbledhje por edhe disa pyetje të cilat i kam parashtruar përgjigjet ende nuk i kam pranuar dhe nuk e di pse nuk jep përgjigjeje.

Sevdi Dernjani thekson:-secili drejtor e ka të drejtën e shfrytëzimit të pushimit e cila i takon me Ligj dhe është çështja e tij se kur e shfrytëzon , mirëpo vetëm Kryetari i Komunës është ai i cili ja lejon apo nuk ja lejon. Drejtorët të cilët kanë pikë për në KPF apo në kuvend duhet të janë prezantë apo të ja delegojnë dikujt pikën për prezantim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND TË GJYSMËVJETOIRT TË DYTË TË VITIT SHKOLLOR 2022-2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6.Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam me shtuar .

Sherif Berisha thekson:- a do të stimulohen fermerët me drithëra , derivate pra a keni diçka konkrete në këtë drejtim.

Refet Kalisi thekson:-a keni informacione që fermerët do të mbjellin më shumë se në vitin e kaluar.

Abduraman Bushi thekson:- ne planifikojmë me mbështetur pjesërisht mbjelljen e grurit apo korrjen e grurit por do ti shikojmë mundësitë buxhetore. Sipas kontakteve që kam besoj që do të ketë më shumë të mbjellura në këtë vit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFROMATA PËR KORRJE SHIRJE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:-disa banorë të fshatit Gorancë kanë shqetësimë dhe personalisht ditën e ejte isha te AMF-ja në fshatin Gorancë dhe nuk ka pasur as mjekë as teknik. Me një takim që kemi pasur me disa bashkë fshatarë të cilët janë në murgat dhe kanë shprehur indinjatë për shkak se nuk kanë marr shërbime të AMF-ja në fshatin Gorancë.

Refet Kalisi thekson:- te parku “Isa Berisha” është bërë një investim shumë i madh por mirëmbajtje nuk ka dhe është çështja e ujitjes së atij parku. Komuna duhet të ndërmerr diçka për çështje të mirëmbajtjes dhe ujitjes.

Nexhmedin Daci thekson:- kemi probleme me mirëmbajtje të rrugëve, objekteve por është problem për shkak të çështjeve buxhetore dhe numrit të punëtorëve që është i kufizuar.

Kryesuesi thekson:- duhet të bëhet përpjekje për këtë çështje edhe për parkun “Isa Berisha” dhe për parkun para komunës. A mund të bëhet zgjidhje përmes qeshmës së Hetemit sepse aj ujë mund të shfrytëzohet për pije te shkollë filllore dhe te shkolla e mesme. A është funksionale tabela e njoftimeve.

Nora Xhoni thekson:- a ekziston mundësi përmes kompanive private që në sezonë të verës me ujitur.

Nexhmedin Daci thekson:- nuk kemi mjete financiare por do të mundohemi përmes lunit “Lepenc”.


Natyra Kalisi thekson:- tabela e njoftimeve është te qendra për shërbime të qytetarëve por operatori ekonomik ka ardhur për çështje të pajisjeve për me i rregulluar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:54.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

